



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-28731/23 datë: 27.10.2023



Npi – 01/384 datë: 30.10.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.10.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë - X - T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E
E mbajtur më: 30.10.2023 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Nga UNMIK-u z.Xhavit Fejza dhe Florent Salihu, Nga njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni dhe praktikantët znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.09.2023,
2. Informatë nga DSHMS dhe diskutim për nevojat dhe mbështetjen e komuniteteve për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (të ftohet drejtori i drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale),
3. Propozim për vizitë në vendbanimet e komuniteteve,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, për pikën e dytë të rendit të ditës, nuk kemi mundësi me diskutu sepse nuk e kemi prezent drejtorin e DSHMS-së.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, është hera e parë që jemi të kopmpletuar kështu. Nuk kemi ndonjë informatë nga DSHMS-ja, ose nuk kemi së paku ndonjë zyrtarë për me na dhënë një informatë, unë mendoj që ja vlenë që së paku ne të diskutojmë këtu bashkarisht për këtë temë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Javën e kaluar kamë bërë një mbledhje me Nënkryetarin, dhe drejtorin e DKA-së dhe kemi diskutuar për shumë tema, unë kamë shpresuar që vjen dikush sot në mbledhje dhe na jep informata sepse mendoj se kemi çka të diskutojmë. Te procesverbali është një gabim teknik sepse e kemi 29.08.2023 e duhet me qenë 28.09.2023.

***Komiteti për Komunitete, me 0 vota “Për”, me 5 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim” nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar zyrtarisht.**

***Komiteti për Komunitete, me 5 vota "Për", me 0 vota "Kundër", dhe me 1 votë "Abstenim" e miratoi rendin e ditës si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.09.2023,
2. Propozim për vizitë në vendbanimet e komuniteteve,
3. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 28.09.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimsht miratoi Ekstrakt Procesverbalin me datë 28.09.2023.**

Pika 2

Propozim për vizitë në vendbanimet e komuniteteve

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, ne boll po e ngrismi zanin, por Komuna e Shtimes nuk po bënë sa duhet. Kur po flasim për vizita në familjet skamnore të komunitetit ata kur shkojmë ne na presin me shpresën që u qojmë diçka. E ne po e ndijmë veten keq për këtë, prandaj mendoj se nuk kemi pse shkojmë sepse munden me na thënë qka keni bërë për ne.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë e kam ftuar edhe Nënkyetarin për ta parë gjendjen e tyre më afër.

z.Besnik Seferi; Pajtohem 99% me parafolësit ne nëse shkojmë në takim çka do të ju japim. Unë sigurisht po them se nuk do ta ndalim presionin ndaj ekzekutivit. Kemi shumë çështje për ti diskutuar. Ne duhet me pas një alternativë. Me keqardhje e them se jamë pjesë e Komitetit por ju e keni më shumë përgjegjësinë ndaj banorëve të Komitetit pakicë. Është mirë që ne të dakordohemi dhe ti adresojmë temat qoftë për mësimnxënje ose për tema të tjera. Ne kemi marrë rekomandime njëra prej tyre është marrë parasysh për ndërtimin e shtëpive. Mirëpo pas konsolidimit të Kuvendit, Kryetari ka thënë se do ti përkrahim.

z.Arton Demiri; Ku është zyra për Komunitete. Më parë nuk ka pas një festë Bajrami që nuk u është ndarë së paku nga 30 euro.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, unë sa herë dalë në qytet më pyesin qytetarët qka po bëni në Komunë, nuk kemi marrë asnjë pako ushqimore.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë vërtet kam ra në mëdyshje, a ka ndonjë propozim se çka mundemi ne me bërë, a me lënë krejt Komitetin e që unë e kisha lënë me dëshirë.

z.Besnik Seferi; Unë jamë pjesë e ekzekutivit, e kur mirren parasysh këto unë mendoj se ne duhet me u shtërngu mirë, tani fund-viti po afrohet dhe duhet të shohim mirë gjendjen, sepse deri tani ja kemi lënë fajin mosfunksionimit të Kuvendit. Por unë prapë i kisha rekomandu Kryesuesit që ta mbajmë në rregull këtë Komitet. Unë nuk pajtohem që ti marrë 140 euro e të dalim me rezultatin zero.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë kisha thënë që të aprovojmë diçka për këtë vizitë, së paku me kushtin që të na bashkangjitet edhe Nënkyetari. Kemi dy propozime mos me bë vizitën fare dhe propozimi im me për me bërë por së bashku me Nënkyetarin dhe 2-3 drejtorë të fushës së përgjegjësisë që kanë.

z.Besnik Seferi; Kjo përgjegjësi le të jetë në dorën e atyre që e kanë drejtorinë në menaxhim. Unë mendoj që më mirë është që ne mos me bërë përcaktimin se për cila drejtori e ka përgjegjësinë.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -X- për vitin 2023, të mbajtur më: 30.10.2023, unanimsht vendosi që anëtarët e Komitetit për Komunitete të bëjnë vizita familjeve skamnore të komunitetit Ashkali e Rom në Komunën e Shtimes, së bashku me Nënkyetarin e Komunës, si dhe me 2-3 drejtorë të fushës së përgjegjësisë që kanë, për t'i parë dhe dëgjuar problemet dhe nevojat e këtyre familjeve.**

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Paras se të hapi diskutimin për këtë pikë, unë kam pas vërejtje te buxheti i Komunës që është miratuar por nuk e kam bërë të madhe për mos me ngarkuar edhe më shumë me telashe Kuvendin përveq atyre që i kishte.

z.Besnik Seferi; Unë i kam propozuar në Kuvend kërkesat e Komitetit për Komunitete për ti futur në dokumentin final të draft buxhetit dhe Kryetari më ka premtuar se do ti kryej. Unë propozoj që të bëjmë një kërkesë për fillimin e procedurës për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë, le të jetë kjo si iniciativë e jona si Komitet, sepse mendoj se ka nevojë të madhe që kjo rregullore të plotësohet dhe ndryshohet.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne e kemi bërë një kërkesë të tillë në muajin Qershorë.

z.Muhamet Mehmeti; Unë propozoj që kuota rexhistrimit të nxënësëve në gjimnaz të rritet e mos të mbesin nxënësit e komunitetit që të shkojnë vetëm në shkollën profesionale.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Një përgjigje për Muhametin në këtë pyetje është se nxënësat vetë po shkojnë te shkolla profesionale, për shkak të mundësive që më herët të punësohen, por edhe për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit, qoftë brenda ose jashtë Kosovës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që të caktoi një takim pune me Kryetarin e Komunës së Shtimes për javën e ardhëshme, për ti biseduar qështjet që u ngritën në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:30h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

